

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës -Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirembajtje e sistemit te ftohjes dhe ngrohjes”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
50720000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,499,445 (shtate milion e katerqind e nentedhjetë e nente mije e katerqind e dyzet e pese) leke pa TVSH.

Kohezgjatja: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e ofertës, sipas shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, të DT;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori ekonomik ofertues duhet të zotërojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga institucionet shtetërore kompetente si më poshtë:

- NS-12/A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit);
- NS-14/A (Impiante të brendshme elektrike, etj);

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 2, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) nenit 41, pika 4/a të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar), si dhe në zbatim të Ligjit Nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, VKM Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kritere të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e shërbimeve të pasqyruara në preventiv. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.2Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar). Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) duhet të jete në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vullë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Udhëzimin nr.7, datë 10.01.2017 “Për disa shtesa në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Në përcaktimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 61, pikat 2 dhe 5, i Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), ku citohet:

.....“2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e

ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”.....

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, *(i ndryshuar)*, duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” *(i ndryshuar)*, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” *(i ndryshuar)*. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” *(i ndryshuar)*. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/et Ekonomik Ofertues duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë përvoja të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)* dhe neneve 41, 55 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” *(i ndryshuar)*. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të

zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet/furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është bazuar në nenin 55 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin të jo më pak se 10 (dhjete) punonjës për tre muajt e fundit të deklaruar të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar;
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar;

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.2) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe neneve 41 pika 4/c, 55 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar punonjës, të pajisur me diploma dhe/ose licenca perkatese sipas rastit dhe/ose çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesën e subjektit për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar, minimumi:

- 1 (nje) inxhinier mekanik;
- 1 (nje) inxhinier elektrik;
- 2 (dy) riparues të kondicionereve dhe sistemeve ngrohës ftohes
- 1 (nje) hidraulik
- 1 (nje) elektrikist

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë dhe/ose licenca perkatese sipas rastit /çertifikatë e arsimit profesional) lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.4) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, nenin 76 pika 3 germa a) të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 7 germa c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

Për sa i përket përcaktimit të punonjësve të kualifikuar nga institucione të arsimit profesional kjo kërkesë del e nevojshme nga shqyrtimi i prevetivit të pasqyruar ku sasia dhe lloji i shërbimeve e bëjnë të domosdoshëm vendosjen e këtij kriteri në funksion të realizimit me sukses të kontratës. AK duhet të garantohet që mirëmbajtja do të kryhet nga persona të specializuar për zbatimin e këtyre shërbimeve me standarte dhe cilësi. Të gjitha paisjet kanë nevojë për shërbime nga një numer i caktuar specialistesh në mënyrë që ti përgjigjen në kohë kërkesave dhe problematikave teknike të punës. Sa më sipër, është shumë e nevojshme që OE duhet të ketë në stafin e tij numrin punonjësve të kërkuar nga AK me qëllim që ti përgjigjet në kohe të gjitha godinave.

- **1 (një) Inxhinier Mekanik;** i cili do të merret me manxhimin dhe kontrollin e përgjithshëm të gjithë punimeve dhe shërbimeve mekanike, që zënë pjesën më të madhe të preventivit.
- **1 (një) Inxhinier Elektrik;** i cili do të merret me manxhimin dhe kontrollin e përgjithshëm të gjithë punimeve dhe shërbimeve elektrike, që zënë një pjesë të rëndësishme të preventivit, të cilat janë pjesë e rëndësishme për mbarëvajtjen, funksionimin dhe riparimin e problematikave të paketave elektronike, erreve te ndryshme, sipas shërbimeve të nevojshme të gjitha pasjisjeve, në integrimin e sistemeve inxhinierike mekanike, elektrike.
- **2 (dy) riparues të kondicionereve dhe sistemeve ngrohës ftohes** do të kryejnë punime montim/montim/riparim ndërrim pjese kembimi de mirembajtje per Chillera, fancoila etj, duke qenë se ne preventiv zë pjesen me të madhe të punimeve, dhe që nevojiten për t'u riparuar e ndërruar dhe mbikqyrur të gjithë procesin e mirëmbajtjes,
- **1 (një) Punonjës specialist elektrikist** do të merret montim/montim/riparim ndërrim pjese kembimi de mirembajtje elektrike te te gjitha paisjeve, automate, leshues, linja elektrike, etj., duke qenë se ne preventiv zë pjesen më të madhe të punimeve, dhe që nevojiten për t'u riparuar e ndërruar e mbikqyrur të gjithë procesin e mirëmbajtjes,
- **1 (një) Punonjës specialist hidraulik** do të merret me montim/montim/riparim ndërrim pjese kembimi dhe per te gjitha linjat e furnizimit me ujë te paisjeve, pompa, etj., duke qenë se ne preventiv zë një pjesen të punimeve, dhe që nevojiten për t'u riparuar e ndërruar e mbikqyrur të gjithë procesin e mirëmbajtjes,

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës i cili të jete i pajisur me çertifikatën e trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" ose ekuivalente dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit deklaruar dhe në, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për punonjës të mesipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente çertifikuese të akredituara/liçensuara.

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.5) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesipërm, emer/mbiemer, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojta për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, nenin 76 pika 3 germa a) të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, Ligjit nr.10327 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shendetin në punë", i cili përcakton se..... *Neni 7....Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit....1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion....*, dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores për sigurinë në kantier". Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me shërbimin e kerkuar si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që shërbimet të realizohen ne perputhje me legjislacionin ne fuqi duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 :2015 per sistemin e menaxhimit te cilesise ose ekuivalente, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001 :2015 per sistemin e menaxhimit mjedisor, ose ekuivalente, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 :2015/2018 per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune ose ekuivalente, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë certifikat ISO e kërkuar eshte e detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të preventivit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën që operatorët ekonomikë të paraqesin certifikata të sistemeve të menaxhimit te cilesise, me qëllim garantimin e kapaciteteve të tyre për realizimin e objektit te procedures sipas standardeve të kërkuara të cilësise.

Kërkesa që certifikata të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga organizmat kombëtarë të akreditimit ose organizma ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë, është përcaktuar me qëllim garantimin e vlefshmërisë, besueshmërisë dhe paanshmërisë së dokumenteve të paraqitura nga operatorët ekonomikë.

Për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të paraqesë certifikaten përkatëse sipas zërave të preventivit që do të realizojë është vendosur me qëllim që çdo subjekt që merr përsipër realizimin e një pjese të kontratës të provojë se disponon sistemet e nevojshme të menaxhimit për fushën konkrete të angazhimit të tij.

Ky kriter nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin që operatorët ekonomikë që marrin

pjesë në procedurë disponojnë kapacitete të organizuara dhe të dokumentuara për menaxhimin e cilësisë, në përputhje me kompleksitetin dhe rëndësinë e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 36, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/a dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në rast se gjatë hartimit të dokumentave të tenderit dhe kërkesave për kualifikim është përmendur ndonjë markë, operatorët ekonomikë ofertues kanë të drejtë të ofertojnë me ekuivalenten e tyre gjatë hartimit të ofertës ekonomike apo dokumentacionit të nevojshëm për të marrë pjesë në këtë procedurë.

VLERA E FONDIT LIMIT

Vlera e fondit limit të kontratës nga grupi i punës i ngarkuar për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, në mbështetje dhe zbatim të pikës 1, shkronja b) të nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: b)Studimi i tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

NJËSIA E PROKURIMIT